



6

PPP.nr. 725/16

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve Arber Rexhepi nga fshati Koshare, Komuna e Ferizajit dhe Bukurije Krasniqi, kundër debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me përmbartimin e kërkesës ne te holla- borxh, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar me datë 29.12.2014 nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.1279/14 datë 16.12.2014, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, në Prishtinë, jashtë seancës, me dt. 25.01.2017, mori këtë:

### AKTVENDIM

**APROVOHET** si i bazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe **ANULOHET** Urdhri Përmbartimor P.nr.1279/14 me dt.16.12.2014, i përmbartuesit Afet Mjeku.

### Arsyetim

Përmbartuesi privat, Afet Mjeku ne Prishtine duke vepruar sipas propozimit për përmbartim te kreditorëve ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr.1279/14, dt.16.12.2014, me te cilin ka lejuar përmbartimin ne baze te aktvendimit te debitorit dt.15.01.2014, për kompensim për personat e verbër, për secilin veç e veç ne shume prej nga 100 €.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, në afatin ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim është theksuar se zyra përmbartimore në fjalë ka lejuar përmbartimin duke shkelur dispozitat thelbësore procedurale Gjithashtu ka theksuar se nuk është bere llogaritja e diferencës se shumes qe kreditorët kane realizuar, me diferencën e shumes qe ju është njohur kompensimi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për këto arsye:

Gjykata vlerëson se debitori me aktvendimin e dt.15.01.2014, kreditorëve ua ka njohur kompensimin për te verbër ne shume mujore nga 100 €, për secilin veç e veç, për periudhën prej dt.01.01.2013 deri me 01.01.2014. Gjykata vlerëson se aktvendimi nuk është pajisur me vërtetim te plotfuqishmërisë dhe me vërtetim te permbarueshmerise, ndërsa përmbartuesi privat para lejimit te përmbartimit nuk ju ka kërkuar kreditorëve qe aktvendimi te pajiset me këto vërtetime dhe nuk ka vërtetuar faktin se cila pjese e kompensimit është paguar e cila pjese e kompensimit te mbetur me u paguar me ekspertë financiar.

Ne rastin konkret kjo gjykate vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e Urdhrit përmbartimor nga ana e përmbartuesit, sepse aktvendimi i marre ne procedure administrative nuk ka vërtetim për permbarueshmeri, ne kuptim te nenit 36. Parl te LPP-se, sikundër nuk është vërtetuar se debitori a ka paguar ndonjë shume te kreditorëve, nëse ka paguar atëherë duhet te vërtetohet se cila pjese ka mbetur pa paguar. Kështu kjo gjykate vendosi te anuloj Urdhrin përmbartimor duke pranuar prapësimin e debitorit.

Për këtë arsye u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit e duke zbatuar nenin 73.3 te LPP-se.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**PPP.nr. 725/16 date 25.01.2017**

**KESHILLE JURIDIKE:** është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

